



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI

---

Numri i lëndës: 2023:160462

Datë: 25.03.2025

Numri i dokumentit: 07041678

P.nr.222/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekaliu, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit M.H nga fshati ..., Komuna Vushtrri, për shkak te veprës penale *Kanosja* nga neni 181 par. 1 të KPRK-së, të pandehurit G.H nga fshati ..., Komuna Vushtrri, për shkak të veprës penale *Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë* nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, si dhe të pandehurit F.K nga fshati ..., Komuna Vushtrri, për shkak te veprës penale *Kanosja* nga neni 181 par. 1 të KPRK-së, të ngarkuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1702/22 të datës 25.07.2023, jashtë seancës, në mbështetje të nenit 248, par. 1, nën par. 1.4, të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës, nenit 8 dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit për ndërmjetësim, me datë 25.03.2025, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET Marrëveshja e Ndërmjetësimit Nr. Ref. ND. 44/2025 e datës 21.03.2025, e arritur ndërmjet të pandehurve M.H, G.H, F.K dhe të dëmtuarit S.K.

II.HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1702/2022 e datës 25.07.2023.

III.PUSHOHET procedura penale për të pandehurit 1. M.H , nga i ati E... dhe e ëma F..., e gjinisë M..., i lindur me datë ..., me vendbanim në fshatin ..., Komuna Vushtrri, me numër personal ..., shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale *Kanosja* nga neni 181 par. 1 të KPRK-së.

2. G.H, nga i ati E... dhe e ëma F..., e gjinisë M..., i lindur me datë ..., me vendbanim në fshatin ..., Komuna Vushtrri, me numër personal ..., shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale *Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë* nga neni 321 par. 1 të KPRK-së.

3. F.K, nga i ati Xh... dhe e ëma F..., e gjinisë G..., i lindur me datë ..., me vendbanim në fshatin ..., Komuna Vushtrri, me numër personal ..., shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale *Kanosja* nga neni 181 par. 1 të KPRK-së.

IV. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

#### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.1702/22 e datës 25.07.2023, i ka akuzuar të pandehurit M.H nga fshati ..., Komuna Vushtrri, për shkak te veprës penale *Kanosja* nga neni 181 par. 1 të KPRK-së, G.H nga fshati ..., Komuna Vushtrri, për shkak te veprës penale *Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë* nga neni 321 par. 1 të KPRK-së dhe F.K nga fshati ..., Komuna Vushtrri, për shkak te veprës penale *Kanosja* nga neni 181 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata, me datë 18.03.2025 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me këtë çështje penale, në të cilën të pandehurit, pas udhëzimeve të gjyqtarit të vetëm gjykues, të dhëna konform dispozitave ligjore, lidhur me procedurën e ndërmjetësimit, kanë deklaruar se nuk kanë probleme, po ashtu pala e dëmtuar është pajtuar që lënda të referohet në procedurë të ndërmjetësimit me qëllim të rregullimit të raporteve. Prokurori i shtetit po ashtu është pajtuar që lënda të referohet në procedurë të ndërmjetësimit, meqë palët i kanë rregulluar raportet mes vete dhe nuk ka pengesa ligjore që kjo çështje penale të zgjidhet përmes procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata ka aprovuar propozimin e palëve dhe e ka referuar këtë lëndë penale në ndërmjetësim pasi që me nenin 2, paragrafi 2, të Ligjit për ndërmjetësim është përcaktuar se ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet në rastet ku parashihet dënimi me gjobë dhe dënimi me burgim deri në tri (3) vjet, përveç rasteve të parapara në paragrafin 3 të këtij neni, e që në rastin konkret për veprën penale me të cilën ngarkohet i pandehuri i parë është përcaktuar dënimi me gjobë ose burgim deri në gjashtë (6) muaj, për veprën penale me të cilën ngarkohet i pandehuri i dytë është përcaktuar dënimi me gjobë ose burgim deri në një (1) vit, për veprën penale me të cilën ngarkohet i pandehuri i tretë është përcaktuar dënimi me gjobë ose burgim deri në gjashtë (6)

muaj, kurse me nenin 8, paragrafi 7, të Ligjit për ndërmjetësim është përcaktuar se pranohet marrëveshja në mes palëve për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, në çdo fazë të zhvillimit të procedurës në gjykatë kompetente, apo në një organ tjetër kompetent.

Gjykata është njoftuar nga ndërmjetësuesi se palët, me datë 21.03.2025, kanë arritur pajtimin në ndërmjetësim, ashtu që janë pajtuar që çështja të zgjidhet përmes ndërmjetësimit, të cilën marrëveshje e kanë nënshkruar dhe e njëjta nga ndërmjetësuesi është proceduar në gjykatë për aprovim të marrëveshjes.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësim, konstatoj se palët pa ndonjë kërcënim dhe me vetë dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje të zgjidhet me ndërmjetësim dhe nuk kanë kontestuar asnjë nga pikat e marrëveshjes së ndërmjetësimit, andaj edhe gjykata të njëjtën e aprovoi si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

Gjykata duke pasur parasysh marrëveshjen e arritur në ndërmjetësimin në mes të pandehurit dhe palës së dëmtuar, e bazuar në neni 357 par. 1, pika 1.3 e lidhur me nenin 229 par. 5 të KPPRK-së, ka vendosur si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale ka vendosur në bazë të nenit 453 par. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.222/2023, datë 25.03.2025

Zyrtarja ligjore

Arta Jusufi

Gjyqtari i vetëm gjykues

Naim Rekalii

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk lejohet ankesa (neni 229 par. 6 të KPP-së).